

Tiranë më __/__/2019

Lënda: **Mbi njoftimin e zhvillimit të mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë SiCRED sh.a.**

Për: **z. Artan XHORI**
z. Selman LAMAJ
znj. Julinda Molla Kasmi

Të nderuar anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë SiCRED sh.a.,

Bazuar në Statutin e shoqërisë SiCRED sh.a., si dhe neneve 154 dhe 161 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", (i ndryshuar) depozitoj në vëmendjen Tuaj, kërkesën për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë SiCRED sh.a., me rend dite të listuar si vijon:

1. "Mbi miratimin e raportit të auditit të pavarur, pasqyrave financiare vjetore të audituara, si dhe pasqyrave financiare të konsoliduara të shoqërisë SiCRED sh.a., të audituara për vitin e mbyllur me 31-12-2018" sipas tekstit që gjeni bashkëlidhur.
2. "Mbi njohjen e rezultatit të shoqërisë SiCRED sh.a., për vitin e mbyllur me 31-12-2018" sipas tekstit që gjeni bashkëlidhur.
3. "Mbi njohjen e miratimin e raportit të vetë-vlerësimit të Riskut të shoqërisë SiCRED sh.a., për vitin e mbyllur me 31-12-2018" sipas tekstit që gjeni bashkëlidhur.
4. "Çështje të tjera parashikuara shprehimisht nga ligji.

Për të gjitha pikat e rendit të ditës dokumentacioni ju dërgohet nëpërmjet formës elektronike në adresën tuaj elektronike ne format të *paeditueshëm pdf*, akte të cilat i gjeni bashkëlidhur këtij njoftimi. Mbledhja zhvillohet me datë 17-05-2019, vendi "SiCRED sh.a.", Tiranë, ora 17.00..

Me respekt,
Genc KOXHAI
Drejtor i Përgjithshëm